



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:084094

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05497107

**Ac.nr.4766/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevc, kryetari i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, Rruga “Fazli Grajqevci”, numër 6, kundër të paditurit M.H nga fshati K., Komuna V., me bazë juridike rimbursim i dëmit në shumë prej 564.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.731/2019 të datës 30.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.731/2019 të datës 30.04.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.731/2019 të datës 30.04.2021, ka vendosur si në vijim: *“I.APROVOHET PJESERISHT kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine, ashtu qe: II.DETYROHET i padituri M.H nga fsh. K../V..i, qe ne emër te rimbursimit te demit te shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i shkaktuar ne fsh. K../Vushtrri, me dt:17.10.2011, sipas numrit 2011-BR-650, paditëses, Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli ne Prishtine, mbi bazën e përgjegjësisë se ndare (lëshimeve primare), t’ia paguaje shumen prej 300 euro, me kamate ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e ushtrimit te padisë dt: 09.09.2013, e gjer ne përmbushjen perfundimtare te detyrimit. III. Secila*

*pale i barte shpenzimet e saj te procedurës. IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë se paditëses ne shume prej 260 euro ne emër te rimbursimit te demit ndaj te paditurit, REFUZOHET E PABAZUAR”.*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e autorizuarës e paditëses, për shkak të shkeljeve të dispozitive të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të së gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe ta aprovoj kërkesëpadinë apo ta prish dhe ta anuloj vendim në tersi si të pabazuar aktgjykim e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.731/2019 të datës 30.04.2021, apo lëndën ta kthej në rigjykim në shkallë të parë apo ta provoj në tëri kërkesëpadinë e paditësit sipas petitumit të padisë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

*-Ankesa është e pathemeltë*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, ka kërkuar që të detyrohet i padituri për rimbursim e dëmit, në shumë prej 564.00 euro, lidhur me rastin e aksidentit të ndodhur në trafik me datën 17.10.2011.

Pas kthimi të lëndës në rigjykim sipas aktvendimit Ac.nr.4163/2017 i datës 18.10.2019 të Gjykatës së Apelit, dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë ka administruar provën me ekspert nga lemia e komunikacionit, ashtu që gjykata e shkallës së parë ka vendosur për aprovimin pjesërisht kërkesëpadisë, konform dispozitës së nenit 423 par.4, lidhur me nenin 143 dhe 147 të LPK-së, duke marr aktgjykim në mungesë të te paditurit. Gjykata e shkallës së parë, bazën e kërkesëpadisë e ka vërtetuar nga shkresat e lëndës dhe nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Ahmet Maxhuni të datës 20.03.2021, i cili ka përcaktuar si lëshime primare veprimet e drejtuesit te automjetit këtu të paditurit Muhamet Haziri, ndërsa lëshime sekondare ka përcaktuar veprimet e këmbësores B.N, ku nga ekspertiza ne lëndore gjykata ka konstatuar se kemi ndarje te përgjegjësisë në rastin konkret dhe mbi këtë bazë, gjykata gjeti se shuma e kërkuar nga paditësja nuk mund të aprovohet në tërësi marr për bazë faktin se i padituri nuk ka përgjegjësi ekskluzive në rastin konkret por se ka përgjegjësi të ndarë, ashtu që, edhe shuma e kompensimit të aprovuar iu referua përgjegjësisë se ndarë, sa i përket kamatës ka vendosur konform nenit 328 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, e ka arsyetuar me nenet 452 par.2 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht nga raporti i aksidentit 2011-BR-650 i datës 17.10.2011, është vërtetuar se i padituri M.H është shkaktar i aksidentit të trafikut, aksidenti i cili ka ndodhur me datën 17.10.2011. Bazuar në dispozitën e nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia parashihet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Meqenëse paditësja me qëllim të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit, me datën 22.12.2011, kishte lidhur ujdj jashtëgjyqësore për zhdëmtim të dëmtuarës B.N, në të cilën parashihet zhdëmtimi në lartësi prej 564.00 euro, fakt ky që vërtetohet nga urdhër transferi i datës 16.11.2012, për çka edhe bazuar në dispozitën e lartcekur, paditësja ka të drejtë regresi në raport me këtu të paditurin, përfshirë këtu kamatën dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata e Apelit, vlerëson se lidhur me pretendimin ankimor të paditëses se gjykata në rastin e vendosjes vë në pikëpyetje provat që gjendjen në shkresat e lëndës dhe serish e rindan përgjegjësin, kur paditësja BSK veç e kishte ndarë në procedurë të kompensimit, pasi që paditësja në rastin e arritjes se pajtimit gjyqësor kanë arritur pajtim konform ndarjes se përgjegjësisë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur lidhur me rimbursimit të demit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i shkaktuar ne fshatin K.. komuna Vushtrri, me datë 17.10.2011, mbi bazën e përgjegjësisë se ndare (lëshimeve primare), t’ia paguaje shumën prej 300 euro, me kamate ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e ushtrimit te padisë datë 09.09.2013, e gjer në përmbushjen përfundimtare të detyrimit, duke marrë për bazë ekspertizës e ekspertit te komunikacionit Ahmet Maxhuni të datës 20.03.2021, i cili ka përcaktuar si lëshime primare veprimet e drejtuesit te automjetit këtu tani të paditurit Muhamet Haziri, ndërsa lëshime sekondare ka përcaktuar veprimet e këmbësore B.N, andaj ne rastin konkret sipas ekspertizës në lëndore kemi ndarje të përgjegjësisë dhe se shuma e kërkuar nga paditësja nuk mund të aprovohet në tërësi marrë për bazë faktin se i padituri nuk ka

përgjegjësi ekskluzive por se ka përgjegjësi të ndarë, prandaj shuma e kompensimit të aprovuar i është referua përgjegjësisë së ndare. Për me tepër gjykata ankimore vlerëson se më asnjë provë shkresore paditësja nuk e ka vërtetuar se me rastin e lidhjes së ujdisë jashtë gjyqësore me të dëmtuarën në këtë rast është ndarë përgjegjësia sepse asnjë konstatimin në asnjë nga shkresat në lëndë të paditëses nuk është theksuar se kompensimi të dëmtuarës B.N në këtë rast ju ka bërë me ndarje të përgjegjësi siç pretendon në ankesë paditësja, për këto arsye kjo gjykata, e përkrahë në tërësi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si të drejt dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.4766/2021 me datë 08.03.2024**

**Kryetari i kolegji**  
Adnan Konushevci